



Komuna Vushtrri

“JETIMAT E BALLKANIT”

MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM

e lidhur në mes të:

Komunës së Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson **z. Xhafer Tahiri** kryetar i komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna)

dhe

Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” Rr. “Bekim Muhaxhiri nr. 18, Prizren, të cilën e përfaqëson **z. Berat Kabashi**, drejtor i Shoqatës.

Neni 1. Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është sigurimi i mjeteve financiare nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit” dhe Komuna e Vushtrrisë për financim të përbashkët për ndërtim të njëzet (20) shtëpive për banim për familje në gjendje të rëndë ekonomike e sociale të cilat nuk e kanë të zgjedhur çështjen e banimit.

Neni 2. Obligimet e Palëve

2.1 Obligimet e Komunës

2.1.1 Komuna e Vushtrrisë, merr përsipër që të participoj me mjete financiare në vlerë prej pesmijë (5,000.00 €) për secilën shtëpi të ndërtuar. Pagesa do të behet nga buxheti i komunës – “Projektet në bashkëfinansim me donatorë” si dhe nga buxheti i transfereve dhe subvencioneve të

komunës, të cilat do të transferohen në llogarinë bankare të Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” nr. XK051110318280000140, në Pro Credit Bank.

2.1.2 Pagesa e mjeteve financiare për këtë projekt bëhet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.1.3 Në rast se ndonjë familje është në gjendje ekstrem të rëndë sociale dhe nuk posedon truall për ndërtim të shtëpisë, komuna do të bëjë përpjekje për të ia siguruar hapësirën e nevojshme për këtë qëllim.

2.2 Obligimet e Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”

2.2.1 Shoqata “Jetimat e Ballkanit” merr përsipër ndarjen e mjeteve tjera financiare të nevojshme për bashkëfinancim përkatësisht për ndërtim të shtëpive të cekur në nenin një të kësaj marrëveshje.

2.2.2 Shoqata “Jetimat e Ballkanit” dhe komuna e Vushtrisë pajtohen që për zgjedhjen e familjeve që do të ju ndërtohet shtëpia ta bëjë komisioni i përbashkët i përberë nga përfaqësuesit e komunës dhe përfaqësuesit e Shoqatës “Jetimat e Ballkanit”.

2.2.3 Shoqata “Jetimat e Ballkanit” do të dorëzoj pa vonesë në komunën e Vushtrisë një raport për ndërtimin e çdo shtëpie të ndërtuar.

2.2.4 Komuna do të cakton një zyrtar profesional në cilësinë e organit mbikëqyrës për përcjellje e realizimit të kësaj marrëveshje.

Neni 3.

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe është e përpiluar në katër kopje në origjinal, nga dy për secilën palë.

Vushtrri më, 30.06.2020

Palët nënshkruese:

z. Berat Kabashi



Shoqata “Jetimat e Ballkanit”

z. Xhafer Tahiri



Kryetari i Komunës